

KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER SIGURIMIN E PERGJEGJESISE CIVILE

NDAJ PALEVE TE TRETA NE MJETET UJORE

1 DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Ligji nr. 10076 date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit", ketu me poshte do te quhet shkurtim ligji.

Rregullorja e Autoritetit Mbyqkyres Financiare miratuar me vendimin nr.53 date 25.06.2009 "Per trajtimin e demeve mbulohen nga kontrata e sigurimit te detyrueshem ne sektorin e transportit", ketu me poshte do te quhet shkurtimisht Rregullorja.

Kushtet e pergjithshme te kontrates per sigurimin e detyrueshem te mbajteseve te motoreve te ujit (JET), skafeve, yachtet, motorbarka, per pergjegjesine ndaj paleve te treta, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht Kushtet e Sigurimit.

Shoqeria e Sigurimeve ANSIG sh.a. ketu me poshte do te quhet siguroesi.

Personi fizik ose juridik, pergjegjesia civile e te cilit ndaj paleve te treta mbulohet sipas kontrates, do te quhet shkurtimisht i Siguruari.

2 OBJEKTI I SIGURIMIT

Siguroesi mbulon pergjegjesine civile te mbajtesit te mjetit ujore, ne perputhje me parashikimet e ligjit dhe te Rregullores dhe brenda kufijve te rene dakort, lidhur me demet jo pasurore (shendetesore) dhe pasurore te shaktuara ndaj paleve te treta per shkak te qarkullimit te mjetit te vogel ujqor te siguruar.

3 SHTRIRJA TERRITORIALE.

Siguroesi mbulon pergjegjesine ndaj paleve te treta, ne kufijte e Ujrave Territoriale te Republikes se Shqiperise, perfshi Ujrat ne thellesi te ketij Terriori, qe perfshihen ne koordinatat gjeografike te percaktuara ne certifikatat e lejet e mjetit lundruer, te leshuara nga Autoritetet kompetente te Republikes se Shqiperise.

4 PERGJEGJESITE

4.1 Ne varesi te perjashtimeve dhe cilesimeve te deklaruaruara ne kete dispozite, Siguroesi do te mbuloje te Siguruarin, si dhe kedo tjeter qe ka ne kontroll mjetin lundruer me lejen e te Siguruarit, kundrejt pergjegjesise civile ndaj paleve te treta si rezultat i pronesise apo kontrollit te mjetit ujqor, deri ne shumen kufi te Pergjegjesise ndaj Paleve te treta te deklaruaruara ne Legjislacionin ne fuqi.

4.2 Siguroesi, brenda shumes se deklaruar me siper, do te paguaje dhe shpenzimet gjyqesore qe behen me miratimin e Siguroesit per mbrojtjen ose ndjekjen e cdo procedure gjyqesore qe lind per apo ne lidhje me nje ngjarje qe sjell pergjegjesi qe mbulohen nga sigurimi duke perfshire procedurat perpara gjykates dhe procedurat per kufirin e pergjegjesise.

4.3 Siguroesi do te emerohet te marre persiper te drejte cdo procedure ligjore qe mbulohet sipas pikes.4.2 ne emer te cdo personi te mbuluar ne sigurim dhe te gjitha keta persona duhet te bashkepunojne teresisht me Siguroesin ne ndjekjen dhe /ose mbrojtjen e ketyre proceseve.

5 PERJASHTIME

Siguroesi nuk mbulon pergjegjesine e mbajtesit te mjetit lundruer ne rast se pergjegjesia lind nga:

a) Cdo person qe ka ne kontroll mjetin lundruer per arsye te tjera pervec privatisht per kenaqesi.

b) Shkelje te detyrimeve qe rrjedhin nga permbajtja e Certifikates se Lundrimit Certifikates se Sigurise dhe Lejes se Lundrimit.

c) Siguroesi nuk mbulon pergjegjesine ndaj paleve te treta per demet qe mund te ndodhin per shkak te pjesmarries se mjeteve ujore ne gara apo konkurime sportive si dhe ne provat perkatese ose kur mbajtesi i mjetit lundruer angazhohet ne:

- Ski ujore
- Ski qe terhiqen me motorskaf
- Akuaplan
- Parashute ujore

- Apo aktivitetet te ngashme ndersa ata jane duke u terhequr nga mjetit lundruer ose duke u pergatitur per tu terheqje, as per pergjegjesine qe rrjedhe nga persona te angazhuar jashte mjetit ujore ne ndonje nga keto aktivitetet.

d) Kur mjeti jepet me qira dhe nuk eshte marre me pare miratimi me shkrim i Siguroesit.

e) Siguroesi nuk do te paguaje kerkesa per demshperblim per cdo gjobe apo denim as per cdo pergjegjesi per deme te denueshme sipas ligjeve ne fuqi. f) Siguroesi nuk do te paguaje kerkesa per demshperblim per pergjegjesi nese mjeti lundruer i deklaruar ne Certifikate, merr pjese ne gara apo teste shpejtesie apo ne ngjarje lidhur me to.

6 TE DHENAT TEKNIKE E MJETIT LUNDRUES, DOKUMENTET

Te dhenat teknike te mjetit te vogel lundruer dhe dokumentet e tjere te nevojshem per leshimin e polices te paraqitura nga i Siguruari, agjenti ose menaxheri i tij perbejne bazen e kontrates midis tij dhe siguroesit. I Siguruari garanton saktesine e te dhenave te deklaruaruara dhe dokumenteve te paraqitura. Nese ndonje pjese e informacionit eshte e pavertete apo e padeklaruar, Siguroesi ka te drejte te nderprese kete siguracion qe prej fillimit tij apo te mos njohe pergjegjesite e tij ne rast demesh.

7 LUNDRIMI DHE PERDORIMI

Mjeti lundruer eshte i mbuluar ndersa lundron brenda kufijve te deklaruar ne Certifikatat e Lejet e leshuara nga Autoritetet kompetente, si edhe ndersa eshte i ankoruar. Ne cdo rast perjashtohen rastet e sigurimit te ndodhura pergjate rimorkimit e transportimit te mjetit ne toke, pervec rasteve kur mjeti

lundruer i nenshtrohet procesit te leshimit te tij ne uje, apo i nenshtrohet kontrolleve apo survejimeve periodike nga autoritet kompetente.

8 PERIUDDHA E SIGURIMIT

Ky siguracion eshte i vlefshem per periudhat e treguar ne Certifikate pervec nderperjes apo perfundimit ne perputhje me kushtet. Nese certifikata tregon nje periudhe me te vogel se 12 muaj ne vazhdim, ne varesi edhe te kushteve te treguara ne Certifikaten e sigurimit, ky siguracion eshte i vlefshem per kete periudhe me kusht qe barka te jete allaj dhe jo e gatshme per perdorim te menjehereshem. Polica e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24.00 te dites se lidhjes se kontrates dhe mbaron ne oren 24.00 te dites se fundit te shenuar ne kontrate.

9 PERDORIM PRIVAT

Mjeti ujore duhet te perdoret vetem me perdorim privat dhe ne drejtimin e tij duhet te kete persona kompetente me miratim te te Siguruarit (te pajisur me Te drejten e Lundrim-Patenta -Detare) dhe nuk do te perdoret me qira apo hua pervec kur eshte rene dakord qe perpara se mjeti do te perdoret per qellim te tjera dhe i Siguruari ka rene dakord te paguaje primin shtese qe kerkohet. Nese bihet dakort qe mjeti mund te perdoret, jepet hua apo me qira, atehere mjeti ujore duhet te Certifikohet per kete aktivitet dhe gjate gjitha kohes te jete nen mbyqkyreje nga nje person i kualifikuar ne menyre te mjaftueshme dhe duhet qe gjate gjitha kesaj kohe te jete nen komanden e nje personi kompetent.

10 TRANSFERIMI I POLICES

Polica e sigurimit mund te transferohet sipas kerkeses se te Siguruarit ne rast se:

- a) Ndryshon pronesine e mjetit ujqor te siguruar;
- b) Mjeti ujore pushon se ekzistuar dhe i Siguruari kerkon qe brenda periudhes se mbetur te mbuloje ne sigurim nje mjet tjeter ne pronesi te tij, kundrejt riillogaritjes se primit deri ne fund te periudhes se sigurimit.

11 KUJDESI I DUHUR

I Siguruari dhe Menaxheret e tij (nese ka) duhet qe te gjitha kohet te ushtroje kujdesin e duhur per te mbajtur mjetin ujqor lundruer ne kushte te pershtatshme per lundrim, dhe te parandaloje ndotjen qpo rrezikun e ndotjes si pasoje e demtimit te mjetit ujore.

12 LIGJSHMERIA

Eshte nje kusht i ketij sigurimi qe i Siguruari dhe cdokush ne komanden e mjetit lundruer te jete ne perputhje me Kodin Detar te Republikes se Shqiperise, Rregullave Detare lokale dhe cdo ligji qe ka lidhje me te dhe te sigurohet qe mjeti lundruer ti pergjigjet cdo rregulli sigurie te aplikueshem dhe fiton cdo leje apo license te kerkuar me ligj ne cdo vend qe ka juridiksion mbi ujerat ne te cilat lundron.

13 PROCEDURA E KERKESES PER DEMSHPERBLIM.

Mosqenja ne perputhje me kushtet e kesaj klauzole mund te paragjykoje kerkesen per demshperblim.

13.1 Nese nje ngjarje ben te linde nje kerkesa per demshperblim sipas cdo seksioni te ketij Sigurimi, I Siguruari duhet te njoftoje sa me shpejte te jete e arsyeshme (e brenda 24 oresh-ne kapitenerine e Portit dhe prane Siguroesit);

13.2 I Siguruari duhet te marre te gjitha hapat e arsyeshem per te ndaluar apo per te minimizuar cdo humbje qe do te ishte e demshperblyeshme sipas ketij sigurimi dhe te minimizojte pergjegjesine ndaj paleve te treta.

13.3 I Siguruari duhet te bashkepunojte plotesisht me Siguroesin per te siguruar informacion dhe deshmitet e duhura dhe duhet te lejojte siguroesin qe te procedoje ne emer te tij (por me shpenzimet e Siguroesit) per te fituar demshperblim nga ndonje pale e trete ne lidhje me mbulimet sipas ketij siguracioni.

13.4 Nese i siguruari ben kerkesa per demshperblim, apo deklarate qe ka lidhje me demshperblimet, per te cilen Siguroesi ka dijeni qe eshte fallco apo mashtruese, apo kur i Siguruari nuk furnizon me informacion ne lidhje me kerkesa per demshperblim, ky siguracion do te behet i pavlefshem qe prej fillimit te tij dhe do ti mbahet i gjitha primi i paguar.

13.5 Nese kerkesa per demshperblim eshte per koston e riparimit, i Siguruari duhet te sjelle te pakte dy kuotime per keto riparime.

13.6 Kerkesa per demshperblim do te paguhet vetem pasi te jete bere riparimi dhe i Siguruari ka bere deklaraten e pranimit te vleres.

13.7 Cdo njoftim i Siguruari duhet ta jape te Siguroesi ne adresen e tij zyrtare te rregjistruar ne QKR. Kushtet e mbulimit me sigurim, te Dhenat e Dokumentet e furnizuara nga I Siguruari dhe Polica e Sigurimit do te trajtohen nga Siguroesi dhe i Siguruari si nje te tere. Firmosja e Polices se Sigurimit nga Siguroesi dhe i Siguruari, presupozon se palet i kane lexuar, kuptuar dhe pranuar te gjitha te drejtat dhe kufizimet qe permban kjo kontrate. Pervec kur shprehet ndryshe ne Certifikate, ky sigurim do te funksionojte ne perputhje me legjislacionin Shqiptar; cdo mosmarreshje ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate eshte ne varesi ekskluzive e juridiksionit te gjykates Shqiptare.

KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE MJETEVE LUNDRUESE

OBJEKTI I SIGURIMIT

Ne zbatim te Ligjit nr.10076, date 12.02.2009 , si dhe Ligjit 10455 date 21.07.2011, Rregullore e AMF nr .53 date 25.06.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit Publik "ANSIG" Sh.a ofron produktin e meposhtem.

Sigurimi mbulon rreziket ndaj te cilave eshte ekspozuar trupi i anijes (Hull) se siguruar gjate gjithë zhvillimit te udhëtimit.

PERKUFIZIME

Ne keto Kushte Sigurimi fjalet e meposhteme do te kene keto kuptime:

I Siguruari: Pronari ose ndonje person tjetër i cili per kete periudhe eshte i ngarkuar si titullar per kete police sigurimi.

Sigurim: Rrisqet qe jane te percaktuara ne policen e sigurimit nga ndonje sigurues ose risigurues.

Anije e Siguar: Anija e cila eshte e siguruar, per rreziket e specifikuar ne kete police sigurimi, nga i Siguruari.

Standart: Te gjitha klauzolat standarte per Hull/Machinery dhe/ose klauzolat e sigurimit, te cilat i jane shtuar kesaj police.

FUSHA E MBULIMIT

Polica e sigurimit te anijes (Hull), mbulon demtimin e anijeve dhe rreziket si me poshte:

- Demet e shkatuara pales se trete gjate operimit te njetit lundruar (Pergjegjesia ndaj paleve te treta)
- Rrezique e detit, liqenit e lumit. Ne keto rrezique mund te perfshihen tufani, stuqia, ajbergu dhe te ngjashme me to.
- Zjarri dhe eksplozioni.
- Vjedhja me ushtrim force nga persona te jashtem.
- Pirateria.
- Demtime nga ngarkesa
- Nderpererja ose demtimi i instalimeve nukleare.
- Termeti, vullkani e rufeja.
- Demtimi i makinerive ose skafit si pasoje e boliereve.
- Neglizhence e riparuesit kur ky defekt eshte njohur dhe pranuar nga siguruesi
- Aksidentet ne operacionet e stacionimit.
- Veprimet keqdashese dhe te qellimeshme

PERJASHTIME NGA MBULIMI

Shoqeria e sigurimeve " ANSIG" sh.a nuk pergjigjet per demtimet e pesuara nga:

- Konfiskimet e anijeve nga autoritetet shtetore
- Demet e shkatuara per neglizhencen e personave te siguruar ose ekujpazhit te tyre.
- Deklarimet e rreme
- Demet e shkatuara nga energjia nukleare
- Kur udhëtimi nuk korespondon me marreveshjen
- Lufta
- Luftat civile, rebelimet revolucionare
- Aktet e dhunes
- Amortizimi
- Efektet e radiacionit jonik dhe termetet
- Perdorimet e anijeve pa dokumentacion te rregullt (autorizim apo licence), te leshuar nga autoritetet mbikqyrese.
- Demet ose humbjet e shkatuara ne rastet kur anija perdoret per ofensiva apo krime.
- Pjeset e cmontueshme te cilat kane qene levizur me pare per qellime sigurie.
- Demet e shkatuara si rrjelloje e moszbatimit te rregullave te sigurimit teknik
- Demet e shkatuara nga vendosja ne anije e objekteve shperthyes.
- Demet qe shkaktohen si rrjedhoje e transportimit te materjaleve shperthyes ose djegese si, karburantet, lubrifikantet e te tjera te kesaj natyre.
- Demet qe ndodhin kur anija nuk eshte ne uje.

NGJARJA E SIGURIMIT

Pergjegjesia e " ANSIG" sh.a ne rast te ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, eshte e limituar deri ne shumen e sigurimit apo limitin e percaktuar ne baze te Ligjit . Ne rast te ndodhjes se demit, i siguruari eshte i detyruar qe te marre te gjitha masat e nevojshme per te shpetuar anijen ose per te minimizuar demin. Kompesimi i demit munde te pakesohet ne raport me shkallen e fajesis se personit te siguruar.

PAGESA E PRIMIT TE SIGURIMIT, KOHEZGJATJA E KONTRATES

Kontrata hun ne fuqi ne momentin e pageses se primit te sigurimit dhe perfundon ne ditën e perfundimit te udhëtimit sipas destinacionit te shenuar ne policen e sigurimit.

Ne rast te ngjarjes se sigurimit, duhet te paguhet nje prim i ri me qellim qe te vazhdoje mbulimi me sigurim.

Primi mund te paguhet me dy keste, por kesti i pare nuk duhet te jete me i vogel se 60 % e primit total, dhe kesti i dyte duhet te paguhet brenda 3 muajive mbas pagimit te kestit te pare.

Ne rast se i Siguruari nuk paguan kestin e dyte, Siguruesit i lind e drejta te prishi Kontraten e Sigurimit dhe te mos ktheje asnje pjese te primit.

PJESA E ZBRITESHME

Pjesa e zbriteshme nuk do te paguhet edhe ne rastet e demtimeve totale, me perjashtim te rasteve kur palet kane rene dakort ndryshe.

TARIFAT E PRIMIT

Tarifa e Primit percaktohet nga ANSIG dhe miratohet nga AMF Bazuar ne ligjin dhe udhezimet ne fuqi.

KLASIFIKIMI

I Siguruari garanton Siguruesin se anija ne kohën e marrjes ne sigurim eshte klasifikuar nga nje shoqeri klasifikuese, e njohur dhe e miratuar nga Siguruesi dhe klasifikimi qendron gjate gjithë periudhes se sigurimit.

I Siguruari garanton si me poshte:

1. Zbaton rregullat e ketij klasifikimi, si dhe zbaton te gjitha rekomandimet e shoqerise klasifikuese
2. Njofton me shkrim Siguruesin per ndonje ndryshim te mundshem te shoqerise klasifikues, per anijen e siguruar, duke zbatuar te gjitha kerkesat dhe rekomandimet e dhena per anijen e siguruar.
3. Ne rast te ngjarjes se sigurimit te njoftoje menjehere shoqerine klasifikuese, per ndonje influence te mundeshme qe mund te kete kjo ne klasifikimin e anijes.
- Ne rastet kur i Siguruari nuk zbaton garancite e mesiperme per anijen e siguruar dhe ne mbeshetje te Akteve te Sigurimit te Marines nr.1906, Siguruesi kryhen veprimet e meposhteme:
4. perfundon mbulimin ne sigurim sipas kesaj police, duke njoftuar me shkrim te Siguruarin. Data e perfundimit eshte data e njoftimit;
5. ndryshon ose pakeson mbulimet e parashikuara ne keto Kushte Sigurimi.

FLAMURI SHTETI

I Siguruari duhet te garantoje se anija eshte paisur me flamur shtetor, i cili eshte i lidhur:

1. me kushtet e ndertimit te anijes, gjendjen aktuale, stafin dhe paisjet e anijes se siguruar.
 2. çfrytesimin dhe vlefshmerine e çertifikates se flamurit.
- Eshte nje nga kushtet kryesore i kesaj police sigurimi, qe te jene plotesuar kushtet e siperme per te gjithë periudhen e sigurimit.
- Ne rastet kur i Siguruari nuk zbaton garancite e mesiperme per anijen e siguruar dhe ne mbeshetje te Akteve te Sigurimit te Marines nr.1906, Siguruesi mund te kryhej veprimet e meposhteme:
3. Te perfundoje mbulimin ne sigurim sipas kesaj police sigurimi, duke njoftuar me shkrim te Siguruarin. Data e perfundimit fillon nga data e njoftimit me shkrim, por kur anija eshte duke udhëtuar, data e perfundimit do te jete ne ditën qe anija arrin ne portin me te afert.

INSPEKTIMI

I Siguruari premtom se eshte dakort qe i siguruari, ose inspektor apo mbikqyres, i autorizuar prej tij, te beje inspektimin e anijes:

1. Perpara se te merret ne sigurim
2. Ne nje kohe, qe Siguruesi e shikon te pershtateshme, gjate periudhes se sigurimit.

I Siguruari premtom se do te bashkepuoje per kete inspektim, dhe do te zbatoje rekomandimet dhe detyrat e lena nga inspektorët, brenda afateve te percaktuara.

Ne rastet kur i Siguruari nuk zbaton premtimet e siperme dhe ne mbeshetje te Akteve te Sigurimit te Marines nr.1906, Siguruesi mund te kryhej veprimet e meposhteme:

3. Te perfundoje mbulimin ne sigurim sipas kesaj police sigurimi, duke njoftuar me shkrim te Siguruarin. Data e perfundimit fillon nga data e njoftimit me shkrim, por kur anija eshte duke udhëtuar, data e perfundimit do te jete ne ditën qe anija arrin ne portin me te afert.

TE TJERA

Mosmarveshjet midis te Siguruarit dhe Siguruesit do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rastet kur ato nuk zgjidhen me mirekuptim, ato do te zgjidhen Gjykatën e Vendit ku eshte lidhur Polica e Sigurimit. Ne qofte se ne dispozitat e ketyre Kushteve te Kontrates se Sigurimit nuk eshte parashikuar shprehimisht ndryshe, do te aplikohen dispozitat ne fuqi te legjislacionit shqiptar per sigurimet